

TRAFIKU I FEMRAVE FAJI EDHE I FQINJËVE

Nga Xhavit Shala

Ne këtë intervistë për revistën “Spektër”¹, duke qenë dhe ne detyrën e Drejtorit të Policisë Kriminale të Shqipërisë, kam synuar jo vetëm informimin e opinionit publik dhe taksapaguesve shqiptar për rezultatet e suksesshme të policisë shqiptare në luftën kundër krimit por edhe sensibilizim e politikës për domosdoshmërinë e rritjes së trysnisë ndaj fqinjëve për të bashkëpunuar në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore.

Revista “Spektër”: Zoti Drejtor ! Kohët e fundit ka pasur disa ngjarje të rënda kriminale. Ka rënë puna e policisë apo është rigjallëruar krimi ?

Xhavit Shala: Është e vërtetë që ka pasur disa ngjarje të rënda kriminale. Si një rast i vjedhjes me pasoje vdekjen e dy personave në Tepelene, vrasja brenda repartit 313 të burgut, vrasje tjetër në Durrës. Por duhet thënë se për të gjitha këto ngjarje, autorët janë vënë përpara përgjegjësisë. Kështu, njeri prej autoreve të vrasjes në burg u kap duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Vrasësi i Alban Danit në Durrës, u identifikua dhe u arrestua brenda 12 orëve. Vrasësit e ngjarjes në Tepelene u kapën brenda 3 ditëve. Kjo tregon forcën e policisë shqiptare. Por jo çdo krim mund të parandalohet. Aq më tepër kur në duart e popullit janë 680 mijë arme dhe miliona municione. Unë mund të them me përgjegjësi që këto dy jave kanë qenë me të suksesshmet e policisë.

Revista “Spektër”: Personi që u asgjësua në Lezhë, pasi mori peng një familje ishte “shume i kërkuar”. Ndërkaq janë dhe afro 1500 të kërkuar të tjerë. Ç’po bën policia për këtë kontingjent ?

Xhavit Shala: Kjo është e vërtetë, ai akuzohej për pesë vrasje, midis të çileve babanë e tij dhe 2 punonjës policie. I kishte shpëtuar disa here policisë. Problemi i tij është ndjekur me përparësi nga policia kriminale. Dhe të dhënat ishin se “nuk ishte larguar në drejtim të paditur” por ndërronte shpesh bazat e strehimit. Puna zbuluese dha frytet e saj. U identifikua vendqëndrimi i fundit, dhe u bë një operacion perfekt. Mund të them se në përvojën botërore raste të tilla përfundojnë tragjikisht me shume të vrare. Megjithatë, që të mos dalim shume nga tema, kapja e personave në kërkim është në nga detyrat parësore tonat, pasi duke kapur këta persona behet edhe një lloj parandalimi i krimit. Sepse ky është kontingjenti për kryerjen e krimeve të tjera. Dhe se dyti, mos kapja e tyre krijon mendimin se edhe pse ke kryer një krim mund të mos ndëshkohesh. Mund të përmend vetëm një shembull për të vërtetuar këtë që thashë më lart. Në janar – shkurt 1999 janë kapur 37 persona në kërkim.

¹ Intervista është botuar në revistën “Spektër” Nr. 10 të vitit 2000.

Ndërsa ne te njëjtën periudhe te këtij viti janë kapur 165 persona. Ju siguroj se përfundimisht shifra e kapjeve do të jone gjithmonë ne rritje.

Revista “Spektër”: Keni drejtuar grupin hetimor “Rinas”. Ç’mund të thoni rreth këtij skandali ?

Xhavit Shala: Desha të përgëzoj këtu revistën tuaj për “ngacmimin” që i beri këtij problemi, megjithëse kjo ishte çështje e filluar nga ana jone që nga Tetori i vitit të kaluar. Ne e ridimensionuam punën edhe luftën për goditjen e trafikeve nëpërmjet Rinasit. Nga ana e policisë kriminale është bere denoncimi që me 25 tetor 1999 ne Prokurorinë e rrethit dhe me pas, janë bere edhe denoncime të tjera. Puna po ecën mire dhe të jeni të sigurt që këtij problemi do t’i shkohet deri në fund. Nuk mund të jap hollësira të tjera pasi operacioni vazhdon.

Revista “Spektër”: Ministri i Rendit ka deklaruar se viti në vazhdim do të jete viti i luftës ndaj krimit të organizuar. Si do të arrihet ky objektiv ?

Ne fakt vete lufta ndaj këtyre trafikeve të paligjshme është pjese e luftës ndaj krimit të organizuar. Ne kemi të intensifikuar luftën tone ndaj trafikut të drogës, të qenieve njerëzore e trafikeve të tjera. Dua të theksoj se porsa i përket problemit të trafikut të qenieve njerëzore, kjo nuk është me një dukuri vetëm shqiptare. Ky trafik në Shqipëri është hallke e një rrjeti rajonal. Këtu mund të përmendim shtetet nga kalon ky trafik. Pra Shqipëria është edhe vetë viktime e këtij trafiku, pasi këto vajza që do të futen në rrugën e prostitucionit në perëndim, në territorin shqiptar hyjnë në disa drejtime si nga Mali i Zi dhe Maqedonia. Ndërkohë, një lufte e organizuar behet vetëm nga policia shqiptare. Siç deklarojnë vajzat që kapen nga policia dhe shkëputen nga rrjeti, deri në kufijtë tanë ata vijnë fare të pa shqetësuar nga policitë e këtyre vendeve. Shume hotele dhe motele të këtyre vendeve janë të dyndura nga këto vajza që presin çastin për të gjetur kalimin për në perëndim. Mendoj që në kuadrin e bashkëpunimit të SEC-it do të ketë një bashkëveprim me të madh në luftën ndaj këtij trafiku.

TREGIMI I JAVES



Drejtori i Policisë Kriminale,
tregon "tradhtarët"

Prostitutat, faji i fqinjëve

Autoritetet policore të shteteve nga ku kalon trafiku i mishit të bardhë, nuk e luftojnë këtë trafik. Këtë të të kuptohet Drejtori i Policisë Kriminale në Ministrinë e Rendit, Xhavit Shala. Me një gjatë diplomatiqe, Shala thotë: "Siç deklarojnë vajzat që kapen nga policia dhe shkëputen nga rrejt, deri në kufijtë tanc ato vijnë fare të pashqetësuara nga policitë e këtyre vendeve". Numri një i antikriminimit shqiptar, përgjigjet për "tronditjen" që kanë shkaktuar ndaj rendit dhe sigurisë, disa nga krimet e rënda të ditëve të fundit. Megjithatë sipas tij, të gjitha krimet e rënda janë zhluar. Në fund të fundit "jo çdo krim mund të parandalohet, sidomos kur i gjithë populli është i armatosur".

Drejtori! Kohët e fundit ka pasur disa ngjarje të rënda kriminale. Ka rënë puna e policisë apo është rigjallëruar krimi?

Është e vërtetë që ka pasur disa ngjarje të rënda kriminale. Si një rast i vjedhjes me pasojë vdekjen e dy personave në Tepelenë, vrasja brenda reparatit 313 të burgut, vrasje tjetër në Durrës. Por duhet thënë se për të gjitha këto ngjarje, autorët janë vënë përpara përgjegjësisë. Kështu, njëri prej autorëve të vrasjes në burg, u kap duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Vrasësi i Alban Dunit, në Durrës, u identifikua dhe u arrestua brenda 12 orëve. Vrasësit e ngjarjes në Tepelenë u kapën brenda tri ditëve. Kjo tregon forcën e policisë shqiptare. Jo çdo krim mund të parandalohet. Aq më tepër kur në duart e popullit janë 680 mijë armë dhe miliona municione. Kështu që unë mund të them me përgjegjësi që këto dy javë kanë qenë nga më të suksesshmet e policisë.

Personi që u asgjësua në Lezhë, pasi mori peng një familje ishte "shumë i kërkuar". Ndërkohë, janë edhe afro 1500 të kërkuar të tjerë. Ç'po bëjnë policia për këtë kontingjent?

Kjo është e vërtetë, ai akuzohej për pesë vrasje, midis të cilëve babanë e tij dhe dy punonjës policie. I kishte shpëtuar disa herë policisë. Problemi i tij është ndjekur me përparësi nga policia kriminale. Dhe të dhënat ishin se "nuk ishte larguar në drejtim të paditur", por ndërronte shpesh bazat e strehimit. Puna zbuluese dhe frytet e saj, u identifikua vendqëndrimi i fundit. Dhe u bë një operacion i klasit të lartë. Mund të them se në përvojën botërore raste të tilla përfundojnë tragjikisht me shumë të vrarë. Megjithatë, që të mos dalim shumë nga tema, kapja e personave në kërkim është një

nga detyrat parësore tonat, pasi duke kapur këta persona bëhet edhe një lloj parandalimi i krimin. Sepse ky është kontingjenti për kryerjen e krimeve të tjera. Dhe së dyti, sepse moskapja e tyre krijon mendimin se edhe pse ke kryer një krim mund të mos ndëshkohesh. Mund të përmend vetëm një shembull për të vërtetuar këtë që thashë më lart. Në janar-shkurt 1999, janë kapur 37 persona në kërkim. Ndërsa, në të njëjtin periudhë të këtij viti, janë kapur 165 persona. Ju siguroj se përfundimet do të jenë gjithmonë në rritje.

Keni drejtuar grupin hetimor për skandalin "Rinas", ç mund të thoni rreth këtij skandali?

Desha të përgëzoj këtu revistën tuaj për "ngacimin" që i bëri këtij problemi, megjithatë kjo ishte një qeshje e filluar nga ana jonë që nga tetori i vitit të kaluar. Ne e ridimensionuam punën edhe luftën për goditjen e trafikëve nëpërmjet Rinasit. Nga ana e policisë kriminale është bërë denonciimi që në 25 tetor 1999 në prokurorinë e rrethit, dhe më pas, janë bërë edhe denoncime të tjera. Puna po çeto mirë dhe të jeni të sigurt që këtij problemi do t'i shkohet deri në fund. Nuk mund të jap hollësiira të tjera pasi operacioni vazhdon.

Ministri i Rendit, ka deklaruar se viti në vazhdim do të jetë viti i luftës ndaj krimin të organizuar. Si do të arrihet ky objektivi?

Në fakt, vetë lufta ndaj këtyre trafikëve të paligjshme është pjesë e luftës ndaj krimin të organizuar. Në keni ridimensionuar luftën tonë ndaj trafikut të drogës, prostitucionit e trafikëve të tjera. Dua të theksoj se pjesa i përket problemit të prostitucionit, kjo nuk është më një dukuri shqiptar. Ky trafik në Shqipëri është ballkë e një rrejtje rajonal. Këtu mund të përmend shtetet nga kalon ky trafik. Pra, shqipëria është viktimitë e këtij trafiku, pasi këto vajza që do të futen në rrugën e prostitucionit në territorin shqiptar, hyjnë në disa drejtme, si nga Mali i Zi dhe Maqedonia. Ndërkohë, një luftë e organizuar bëhet vetëm nga policia shqiptare. Siç deklarojnë vajzat që kapen nga policia dhe shkëputen nga rrejt, deri në kufijtë tanc ato vijnë fare të pashqetësuara nga policitë e këtyre vendeve. Shumë hotele dhe motele të këtyre vendeve janë të dyndura nga këto vajza që presin çastin për të gjetur kalimin për në Perëndim. Mendoj që në kuadrin e bashkëpunimit të SEC-it, do të ketë një zotim më të madh në luftën ndaj këtij trafiku. ■